

ARGUMENTUM

news opinion analysis



EKSKLUZIVE

**Kandidati për President
në RMV, Arben Taravari:
Ndryshimi është
imperativ i kohës!**

-Maqedonia e Veriut si fushë-
betejë e interesave politike të
kryeministrave Rama dhe Kurti

-Kryeministri Rama
mikpritet nga Presidenti i
Francës në Pallatin Elysee

-Parlamenti Evropian miraton
planin prej 6 miliardë eurosh
për Ballkanin Perëndimor

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- Kandidati për president në Maqedoninë e Veriut, Z. Arben Taravari: Ndryshimi është imperativ i kohës!

07 FOKUS

- Maqedonia e Veriut si fushëbetejë e interesave politike të kryeministrave Rama dhe Kurti
- DASH: Problemet në pavarësinë e gjyqësorit dhe medias, korrupsioni, ndërhyrja e politikës, shqetësimet kryesore për Shqipërinë

13 POLITIKË

- Speciale/ Nga nderimet ushtarake të marrëveshjet Shqipëri-Francë gjatë vizitës zyrtare të Ramës në “Elyse”
- Macron: Mbështetje Shqipërisë për integrimin evropian, të impresionuar nga tërësia e reformave
- Parlamenti Evropian miraton planin prej 6 miliardë eurosh për Ballkanin Perëndimor

17 REALPOLITIK

- “Asigjallësisivdekur!” “Oksigjen” përkonomi në Gjermani!
Plot vizita dhe samite po produkti? Autonomi strategjike evropiane! Shqipërinë nuk e mbron vetëm Kryeministri!

20 RAJONI

- Zgjedhjet presidenciale në RMV/ Ku ndahen dhe ku

bashkohen partitë politike shqiptare dhe maqedonase

24 BOTA

- “Evropa është e vdekshme”, paralajmëron sërish Macron ndërsa bën thirrje për më shumë unitet e sovranitet të BE

ENGLISH EDITION

26 ENGLISH TOP NEWS

- Opposition Candidate Wins First Round of North Macedonia’s Presidential Vote

- Paris, Prime Minister Rama is honored at the official ceremony held in the Court of Honor of “Les Invalides”

28 BALKAN OVERVIEW

- Electoral elections as geopolitics: North Macedonia towards the West or Russia and Germany’s reaction

30 REALPOLITIK

- Zelenski in Tirana! Summit for the sake of summit! Not like Nastradin’s music! If you want peace, prepare for war! EBRD and Basso strips off our veil!

31 GLOBAL

- Iran attacks Israel with over 300 drones, missiles

KANDIDATI PËR PRESIDENT NË MAQEDONINË E VERIUT

Z. Arben Taravari: Ndryshimi është imperativ i kohës!

Intervistë Ekskluzive për ARGUMENTUM.al me Kryetarin e Aleancës për Shqiptarët dhe kandidatin për president i koalicionit "VLEN" në Maqedoni të Veriut, Z. Arben Taravari



Intervistoi: Marjana Doda

“Bashkimi i opozitës shqiptare ishte një fenomen që po ndodhte për herë të parë në vend. Duke qënë pjesë e këtij bashkimi historik vendosa të pranoj propozimin e opozitës, pra të VLEN-it për të qënë kandidat i tyre. Propozim i VLEN-it është ofertë të cilën populli e mirëpret”



Kryetari i Aleancës për Shqiptarët dhe kandidati për president i koalicionit VLEN në Maqedoni të Veriut, Z. Arben Taravari në një interviste ekskluzive për Argumentum.al flet për bashkimin e opozitës shqiptare dhe propozimin që u bë nga ky koalicion si kandidat për president i Maqedonisë së Veriut.

“Bashkimi i opozitës shqiptare ishte një fenomen që po ndodhte për herë të parë në vend. Duke

qënë pjesë e këtij bashkimi historik vendosa të pranoj propozimin e opozitës pra të VLEN-it për të qënë kandidat i tyre. Propozim i VLEN-it është ofertë të cilën populli e mirëpret”, thotë z. Taravari

Lidhur me përçarjet brenda partisë Aleanca për Shqiptarët, dhe konkretisht bashkimin e Zijadin Seles me koalicionin e BDI-së, Z. Taravari e quan një lëvizje befasuese dhe të trishtuar të ndërmarrë nga Zijadini. “Ishte e

vështirë të shikoja mikun e bash-këpartiakun tim, Kryetarin historik të Aleancës që u krijua dhe madhështua pikërisht se donte çlirimin e pushtetit dhe shtetit nga duart e BDI-së t'i bashkohet bash BDI-së”.

Si kandidat për president në krye të shtetit maqedonas, Z. Taravari thotë se një nga pikat prioritare të agjendës presidenciale është distancimi nga “Ballkani i Hapur” “Ballkani Hapur”, de facto në esencë të tij ka mendësinë e një Ballkani të Mbyllur deri dhe të rrezikshëm”, shprehet ai.

Sa i përket përfshirjes së mundshme të kryeministrit Rama dhe Kurti në zgjedhjet e RMV-së, Z.Taravari e vlerëson si një ndihmë të rëndësishme për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut duke thënë se z.Kurti është mbështetës i deklaruar publikisht i VLEN-it. Madje ai thekson se z.Kurti është një nga emrat që di të sjellë ndryshime.

I pyetur për koalicionet e mundshme paszgjedhore, me BDI-në apo dhe me VMRO-DPMNE, kandidati i koalicionit “VLEN” thotë se nuk përjashton asgjë që do të jetë në shërbim të Maqedonisë. “Do të krijojmë Qeverinë e Re me atë ose ato parti të cilat do të jenë pjesë e vizionit për një Maqedoni Ndryshe”, thotë Z. Arben Taravari në intervistën e mëposhtme:

-Zoti Taravari, duke ju falënderuar për këtë intervistë, po e nis me një pyetje të drejtpërdrejtë. Pse vendoset të kandidoni për president të Maqedonisë së Veriut? Pse jo për kryeministër dhe çfarë i ofroni elektoratit që po i kërkoni tju votojnë?

Përshëndetje! Nuk vendos-

sa të kandidoj por pranova propozimin për të qënë kandidat për president. Tingëllon si lojë fjalësh por në fakt është përgjigja më konkrete për pyetjen tuaj. Dua të them që unë as nuk e kisha ndërmend të isha pjesë e garës presidenciale. Në momentin që ndodheshim politikisht isha totalisht i impenjuar me dinamikat partiake. Ndërkohë bashkimi i opozitës shqiptare ishte një fenomen që po ndodhte për herë të parë në vend. Duke qënë pjesë e këtij bashkimi historik vendosa të pranoj propozimin e opozitës pra të VLEN-it për të qënë kandidat i tyre. Vendosa sepse opozita Shqiptare është shprehëse e vullnetit më të madh të popullit, ndaj mendoj që çdo



Interesant është fakti se opozita Shqiptare për herë të parë është e bashkuar dhe fituese që në tavolinë. Qytete të mëdha shqiptare me votë përcaktuese si janë Tetova dhe Gostivari, janë dy domene anti-Bdi që e kanë shprehur me votë pozicionin e tyre. Në Shkup terreni sa vjen dhe ju ngushtohet sepse Izet Mexhiti atje është figura politike më e fortë për shqiptarët. Kumanova është surprizë. Struga dhe Dibra po befasojnë, e kështu me radhë çdo qytet, ndaj BDI-ja është në panik, sepse ka filluar bën gati valixhet për të ikur pas kaq shumë vitesh nga pushteti të cilin e keqpërdori.

propozim i VLEN-it është ofertë të cilën populli e mirëpret.

-Është interesant fakti se në këto zgjedhje të dyfishta në Maqedoninë e Veriut, kryefjala janë partitë politike shqiptare. Opozita përballë BDI-së që prej 23 vitesh ka qënë pjesë e pandashme e qeverisë në pushtet herë me LSDM-në dhe herë me VMRO-DPMNE. Duket një beteje e ashpër politike mes shqiptarëve apo jo?

Që BDI-ja është prej tashmë 23 vjetësh(që për jetëgjatësinë e Maqedonisë si shtet përkthehet 230 vjet pushtet), pra fakti që BDI-ja ka arritur të ndajë pushtetin me parti maqedonase për kaq shumë kohë është tregues i qartë i korrupsionit dhe regjimit të kësaj partie. Interesant është fakti se opozita Shqiptare për herë të parë është e bashkuar dhe fituese që në tavolinë. Qytete të mëdha shqiptare me votë përcaktuese si janë Tetova dhe Gostivari, janë dy domene anti-Bdi që e kanë shprehur me votë pozicionin e tyre. Në Shkup terreni sa vjen dhe ju ngushtohet sepse Izet Mexhiti atje është figura politike më e fortë për shqiptarët. Kumanova është surprizë. Struga dhe Dibra po befasojnë, e kështu me radhë çdo qytet, ndaj BDI-ja është në panik, sepse ka filluar bën gati valixhet për të ikur pas kaq shumë vitesh nga pushteti të cilin e keqpërdori.

-Ish-kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela, ka vendosur t'i bashkohet koalicionit zgjedhor të udhëhequr nga Bashkimi Demokratik për Integrim në Maqedoninë e Veriut. Si e vlerësoni këtë zhvillim dhe sa do të ndikojë kjo në votën



e elektoratit shqiptar për koalicionin tuaj dhe konkretisht për partinë tuaj?

Kjo është një nga lëvizjet më befasuese dhe më të trishtuara që e kam parë Zijadinin të ndër-marrë. Ishte e vështirë të shikoja mikun e bashkëpartiakun tim, Kryetarin historik të Aleancës që u krijua dhe madhështua pikërisht se donte çlirimin e pushtetit dhe shtetit nga duart e BDI-së t'i bashkohet bash BDI-së. Gjithsesi...Zijadinin e njoh shumë mirë dhe nuk besoj kurrë që e ka bërë me gjithë zemër këtë bashkim. Ky është një moment aspak i mirë në karrierën e tij, dhe dua të besoj se nuk do përcaktojë fundin e tij politik. Nga ana tjetër devijimi dhe ikja e tij me BDI-në ishte një motivim dhe shtim i madh i elektoratit tonë. U quajt si tradhëti nga populli dhe ndëshkimi i Ziadinit do të duket në 8 maj sepse vërtet ishte një lëvizje e padrejtë dhe e pamundur e tij.

-Ndarja e Partive politike shqiptare në dy blloqe të medha, ka zgjuar interesin e Prishtinës dhe Tiranës zyrtare. Flas për mbështetjen që përflitet se Kryeministri Rama po i jep Ali Ahmetit, dhe Albin Kurti koalicionit tuaj. Duke ditur dhe mospajtimet politike të theksuara ndërmjet dy kryeministrave shqiptarë, a mendoni se këto zgjedhje po kthehen në demonstrim force të Ramës dhe Kurtit në Shkup? Sa i shërben shqiptarëve në RMV kjo përfshirje e tyre në këto zgjedhje?

Sado dallime të mëdha të ketë midis dy kryeministrave shqiptarë Kurti dhe Rama, ato bashkohen nga një gjë që i tejkalon këto dallime, dhe ajo nga është Etnia e Tyre! Mbeten dy përfaqësuesit më

të rëndësishëm politik të Kosovës dhe Shqipërisë. Ndhima e tyre është shumë e rëndësishme për ne. Sa i përket situatës aktuale politike z.Kurti është mbështetës i deklaruar publikisht i VLEN-it. Jam i gëzuar që kemi mbështetjen e tij sepse z.Kurti është një nga emrat që di të sjellë ndryshime, dhe në Maqedoni veçse ka filluar Ndryshimi.

Jeni zotuar se në rast të zgjedhjes si president i RMV-se, do t'i propozoni kuvendit daljen nga nisma rajonale "Ballkani i Hapur", duke ditur se kjo nismë mbështetet gjerësisht nga kryeministri i Shqipërisë dhe kundërshtohet katërcipërisht nga kryeministri i Kosovës.



Është nga pikat prioritare të agjendës time presidenciale distancimi nga projekti qesharak "Ballkani Hapur" ku de facto në esencë të tij ka mendësinë e një Ballkani të Mbyllur deri dhe të rrezikshëm. Dihet publikisht se në këtë projekt nuk përfshihet Kosova si shtet sovran dhe i pranuar nga Serbia, dhe kjo mosnjohje tregon se në fakt futemi të pabarabartë dhe me probleme në projekt. Si mund të pretendohet për respekt reciprok kur dikush as nuk të njeh si shtet?! Që të ketë qarkullim të lirë ndërkuftar fillimisht duhet pranuar kufiri i secilit shtet.

A është ky qëndrim i juaj ndaj Ballkanit të Hapur për shkak të mbështetjes së Kurtit ndaj koalicionit "VLEN"? Cili është mendimi juaj konkretisht për nismën e Ballkanit të Hapur?

Po. Është nga pikat prioritare të agjendës time presidenciale distancimi nga projekti qesharak "Ballkani Hapur" ku de facto në esencë të tij ka mendësinë e një Ballkani të Mbyllur deri dhe të rrezikshëm. Dihet publikisht se në këtë projekt nuk përfshihet Kosova si shtet sovran dhe i pranuar nga Serbia, dhe kjo mosnjohje tregon se në fakt futemi të pabarabartë dhe me probleme në projekt. Si mund të pretendohet për respekt reciprok kur dikush as nuk të njeh si shtet?! Që të ketë qarkullim të lirë ndërkuftar fillimisht duhet pranuar kufiri i secilit shtet. Rreziku që sjell ky projekt është që Serbia të normalizojë absurditetin e pretendimit të saj në Kosovë.

Qëndrimi im kundër këtij projekti ka qënë i tillë prej momentit të parë që u njoha me të por më vjen mirë që përkon dhe me qëndrimin e z.Kurti të cilin e kemi mbështetës tonin.

-Duke marrë parasysh rezultatin zgjedhjeve lokale të vitit 2021, ku u tronditen veçanërisht dy partitë politike në pushtet LSDM-ja dhe BDI. LSDM me në krye Zoran Zaev humbi Shkupin, ndërsa Ali Ahmeti humbi bastionin e BDI-së, Tetovën. A mendoni që do të përsëritet ky rezultat edhe në zgjedhjet parlamentare të 2024? A është gati koalicioni VLEN të formoje qeveri me VMRO-DPMNE?

Jam i bindur që do të ketë rokadë politike dhe do të krijojmë Qeverinë e Re me atë ose ato par-



ti të cilat do të jenë pjesë e vizionit për një Maqedoni Ndryshe, mikeshë e shtetasve të saj dhe jo armike që i përzë në mërgim.

-Në retrospektivën politike, koalicionet paszgjedhore kanë prodhuar surpriza të mëdha. Përpos retorikës së ashpër që nxit gara elektorale, a është e mundur një bashkim i dy koalicioneve të partive shqiptare, "VLEN" dhe "Fronti Europian" për të formuar qeverinë me LSDM-në?

Aktualisht duket një kombinim i vështirë për shkak të mentalitetit që kanë partitë në pushtet, por nuk përjashtoj asgjë që do të jetë në shërbim të Maqedonisë.

-Sa i përket programit tuaj për zgjedhjet parlamentare, si koalicion ju keni shpalosur katër shtylla kryesore nga programi juaj. A mund ti sqaroni me hollësisht se çfarë mund të bëni ju ndryshe nga qeveritë e deritanishme në pushtet sa i përket integritetit të vendit në BE, ndryshimet kushtetuese, shtetit të së drejtës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal?

E para dhe më e rëndësishmja që përbën Ndryshimin Esencial ne do të angazhohjmë njerëz profesionistë, ekspertët e seriozë që do të jenë pjesë e funksioneve. Pra, si i gjithë programi që është hartuar nga ekspertë edhe zbatimi i tij do të bëhet nga ekspertë.

Meritokracia është një mungesat flagrante aktuale që ka sjellë largimin e njerëzve nga vendi, dhe deformimin e atyre që paguhen gabimisht. Kjo ka sjellë një shtet të dobët, plot Korrupsion. Ndryshimi i të punësuarve partiakë me profesionistë, do të jetë ndoshta pika ku do të fillojë

gjithçka tjetër. Theksoj se ne nuk do të nxjerrim askënd nga puna në shenjë hakmarrje, madje e kundërta, ne do të shtojmë vende pune por duke vendosur secilin aty ku ka mjeshtri dhe aftësi. Do të krijojmë një Sistem Miqësor që do i mbroj dhe ofroj mundësi sa më të mira nënshetasve të tij.

-Lidhur me bashkëpunimin rajonal. Konkretisht si i konsideroni marrëdhëniet aktuale midis RMV-së dhe Shqipërisë, si politikisht dhe ekonomikisht? Dhe çfarë do të bëni për të afruar më shumë dy vendet tona nëse do të jeni në krye të shtetit maqedonas?

Shqipëria është një partner shumë i rëndësishëm strategjik i Maqedonisë dhe një aleat sivlla i shqiptarëve pasi jemi një komb. Dy shtetet kanë shumë për t'i ofruar njëri-tjetrit. Sidomos turizmi i Shqipërisë, i cili është në rritje e sipër dhe po kthehet në një nga më të kërkuarit në botë, do të jetë një sektor ku ne do të mundohemi të krijojmë kushte të veçanta dhe të favorshme për qytetarët tanë. Arti dhe kultura ndërkohë është një nga sferat e rëndësishme që do të përqëndrojmë bashkëpunimin tonë sepse ashtu siç dihet gjuha shqipe është një dokument historik i jashtëzakonshëm 6-mijë vjeçar që mban brenda shumë të vërteta që duhen studiuar dhe kuptuar.

“

Më e rëndësishmja që përbën Ndryshimin Esencial ne do të angazhohjmë njerëz profesionistë, ekspertët e seriozë që do të jenë pjesë e funksioneve. Pra, si i gjithë programi që është hartuar nga ekspertë edhe zbatimi i tij do të bëhet nga ekspertë.

-Ndërsa fushata elektorale ka filluar zyrtarisht, vë re sërish një ndarje të kampeve politike në RMV. Kur do vijë koha që partitë politike si shqiptare apo maqedonase të mos llojnë vetëm si "shqiptarë për shqiptarët" dhe "maqedonas për maqedonasit", por duke kërkuar votën të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut pa dallim etnie?

Në fakt mendoj se mentaliteti i shumicës të partive është "vota për pushtet"...kjo ndarja kinse etnike është një truk më shumë që përdorin për të aktivizuar popullin që ka ndjeshmëri ndaj kombit...do duhet që intelektualisht të ketë ngritje dhe ekonomikisht padyshim, që të krijohet vetdija politike që nuk bërtitet më me nacionalizma e sidomos në një vend si Maqedonia.

-Përpos të gjitha premtimeve elektorale, për ju si qytetar i këtij vendi së pari dhe më pas si politikan, çfarë është sot jetike për Maqedoninë e Veriut dhe për qytetarët e saj?

Ndryshimi i Sistemit. Korrupsioni dhe metastazat e tij kanë 23 vjet që gërryejnë këtë shtet. Largimi i njerëzve nga vendi, shtëpitë që mbyllen çdo ditë e më shumë tregojnë se ka ardhur piku i durimit. Ndryshimi është imperativ i kohës.

Maqedonia e Veriut si fushëbetejë e interesave politike të kryeministrave Rama dhe Kurti

Pse ndërhyrja e Tiranës dhe Prishtinës në zgjedhjet parlamentare e presidenciale nuk i shërben Maqedonisë së Veriut?



MARJANA DODA

Pse ndërhyrja e Tiranës dhe Prishtinës në zgjedhjet parlamentare e presidenciale nuk i shërben Maqedonisë së Veriut?

Marjana Doda

Maqedonia e Veriut, është kthyer në fushëbetejë politike midis kryeministrit Rama dhe kryeministrit Kurti duke u përfshirë në zgjedhjet e dyfishta, ato parlamentare dhe presidenciale në vend.

Kjo ndërhyrje e kryeministrave shqiptarë të rajonit rrezikon pikërisht faktorin politik shqiptar, që padiskutim është katalizator i stabilitetit politik përballë sfidave të brendshme dhe të jashtme të Maqedonisë së Veriut.

Pikëpyetje të mëdha lindin ndërsa shohim një ambicie pan-shqiptare të dy kryeministrave Rama dhe Kurti për ndikim apo dominim politik në hapësirën shqiptare. Duket se Partia Socialiste e kryeministrit Edi Rama në Shqipëri dhe Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin Kurti në Kosovë janë në një garë të ethshme për pushtet përtej kufijve në Maqedoni por dhe në Mal të Zi.

Megjithatë më e theksuar mbetet Maqedonia e Veriut.

Kryeministri Edi Rama, ka luajtur kartën e ndërmjetësimit mes partive shqiptare në Maqedoninë e Veriut në një moment kyç ku vërtet rrezikohej stabiliteti i vendit, në mënyrë të veçantë për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut.

Në atë kohë, “Platforma e Tiranës

” ishte një akt i domosdoshëm që uli në tavolinë të gjitha palët, për të krijuar qeverinë e stabilitetit në Shkup.

Ndërsa sot, sa i përket ndërhyrjes së Kurtit në zgjedhjet politike në RMV, duhet thënë se ana pozitive e angazhimit të Albin Kurtit në këto zgjedhje ishte bashkimi i opozitës shqiptare në një bllok të vetëm. Kjo do të forcojë padiskutim partitë shqiptare duke garantuar më shumë deputetë shqiptarë në parlamentin maqedonas.

Por a është ky qëllimi i Kryeministrit Kurti?

Vështirë të thuhet se ky është misioni politik i Kurtit në Maqedoninë e Veriut.

Në fakt kjo lëvizje ka si qëllim krijimin e një fronti të përbashkët kundër nismës Ballkani i Hapur, iniciuar nga Rama, Zaev,

dhe Vuçiç.

Një nismë që ndonëse u zbeh pas riaktivizimit të “Procesit të Berlinit”, frymon ende në Beograd-Tiranë dhe Shkup.

Albin Kurti ka mbetur vetëm në rajon përballë Vuçiçit dhe me të drejtë kërkon të ndërtojë aleanca mes shqiptarëve në rajon. Por kjo përballje nuk është vetem ndaj presidentit serb, Vuçiç por dhe ndaj kryeministrit Rama, i cili ky i fundit nuk ia ka bërë të lehtë qeverisjen Kurtit.

Një rivalitet i hapur mes tyre është lexuar jo vetëm në Prishtinë e Tiranë, por dhe në korridoret e institucioneve ndërkombëtare. Ndërsa sot shohim zgjatim të këtij rivaliteti edhe në Shkup, ku për herë të pare po ndihet një beteje e ashpër politike mes dy blloqeve shqiptare.

Pra një nga qëllimet e Lëvizjes Vetëvendosje në Maqedoninë e Veriut është rrëzimi nga pushteti i partisë shqiptare, “Bashkimi Demokratik për Integrim”, i udhëhequr nga Ali Ahmeti, mbështetës i ideve të Edi Ramës për të sjellë në pushtet partitë opozitare me të cilat Kurti bashkëpunon.

Vetë Ali Ahmeti, në një intervistë për median shqiptare Top Channel në janar të këtij viti, duke iu referuar raporteve të dy kryeministrave, Edi Ramës dhe Albin Kurtit, me partitë politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut, theksoi:

“Edi Rama asnjëherë nuk ka ndërhyrë në punët e brendshme të organizimit politik në Maqedoni [të Veriut]. Përherë ka bërë përpjekje për t’i afruar partitë politike në Maqedoninë [e Ve-



Një rivalitet i hapur mes tyre është lexuar jo vetëm në Prishtinë e Tiranë, por dhe në korridoret e institucioneve ndërkombëtare. Ndërsa sot shohim zgjatim të këtij rivaliteti edhe në Shkup, ku për herë të pare po ndihet një beteje e ashpër politike mes dy blloqeve shqiptare. Pra një nga qëllimet e Lëvizjes Vetëvendosje në Maqedoninë e Veriut është rrëzimi nga pushteti i partisë shqiptare, “Bashkimi Demokratik për Integrim”, i udhëhequr nga Ali Ahmeti, mbështetës i ideve të Edi Ramës për të sjellë në pushtet partitë opozitare me të cilat Kurti bashkëpunon.

riut] dhe unë sigurisht që i jam falënderues dhe mirënjohës... Por, ka ndodhur rasti për zgjedhjet presidenciale, kur zoti Kurti mbajti anë”. Megjithatë në këtë artikull do të shohim qartë se edhe Tirana zyrtare dhe Kryeministri Edi Rama po ndërhyjnë në këto zgjedhje duke përkrahur drejtpërdrejtë Ali Ahmetin dhe partinë BDI.

Ndasitë politike Rama-Kurti dhe akuzat për ndërhyrje të brendshme në Tiranë dhe Prishtinë

Shembulli se si ndërhyrje të tilla të jashtme qoftë dhe mes shqip-

tarësh janë tejet të rrezikshme, janë konkretisht marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë, ku përtej faktit që jemi një komb, përpos lidhjeve politike, ekonomike e social-kulturore, vitet e fundit ka pasur akuza për ndërhyrje në punët e brendshme si të qeverisë së Tiranës, ashtu edhe të asaj të Prishtinës. Pra, akuzat kanë qenë të ndërsjella.

Përplasjet verbale mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe atij të Shqipërisë, Edi Rama janë të njohura dhe kanë një linje konsistente përgjatë pesë viteve të fundit.

Janë disa qëndrime të kryeministrit Rama që janë kritikuar si të dëmshme nga Qeveria e Kosovës – duke filluar nga mbështetja e tij për idenë e ndryshimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë, nisma Ballkani i Hapur e deri te paraqitja e një draft-propozimi për formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Viti 2018 ishte pikërisht viti që nxori në pah ndarjet politike mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Në verën e vitit 2018, mekanizma të ndryshëm shpërfaqën idenë e “korrigjimit” apo “përcaktimit” të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si zgjidhje e mundshme për mosmarrëveshjet mes dy shteteve. Kurti, asokohe, e kritikoi Ramën për mbështetjen e kësaj ideje.

Ideja e ndryshimit të kufijve nga Hashim Thaçi dhe mbështetja e Edi Ramës për këtë marrëveshje, tronditi marrëdhëniet mes shqiptarëve këtej dhe matanë kufirit.

Kjo solli akuza për tradhëti kombëtare, dhe u bë më e zëshme aleanca e opozitës në Shqipëri

me atë në Kosovë, pra aleanca Berisha – Kurti.

Por e menjëhershme ishte dhe “hakmarrja” e Kurtit ndaj Ramës.

Në dhjetor të po atij viti, Kurti mbështeti protestat e studentëve të universiteteve publike në Shqipëri, që kundërshtonin tarifën e larta të shkollimit dhe kërkonin cilësi më të lartë në arsim.

Në protestat e studentëve të viteve 2018-2019, e dyta më e madhe në historinë e Shqipërisë, u akuzua Partia Vetëvendosje në Tiranë, pra partia e Albin Kurtit si nxitëse dhe si dorë e fshehur që lëvizte fijen e protestave studentore që në fakt tronditi seriozisht qeverinë Rama.

Pas kësaj në Shqipëri, Lëvizja Vetëvendosje hyri në skenën politike në vitin 2019, ndonëse u regjistrua në gjykatën e Tiranës jo si parti politike, por si një qendër. Në atë kohë u tha se “Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje u ngrit për të rritur vetëdijen dhe angazhimin në lidhje me çështjen kombëtare shqiptare”. Por më 25 prill 2021, partia e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje, garoi në zgjedhjet e përgjithshme në Shqipëri, në tri bashki të Shqipërisë: Tiranë, Lezhë dhe Gjirokastrë.

Pjesë e fushatës zgjedhore u bë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Në fjalimet e tij nëpër këto tri qytete, ai kërkoi mbështetje për “alternativa të reja”, duke theksuar se figurat, praktikat dhe idetë e konsumuara për 30 vjet, nuk mund të prodhojnë asgjë të re për qytetarët e Shqipërisë.

E pra vija e kuqe që kaloi Albin



Kurti janë pikërisht zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë, (2021) ku Kurti, ndonëse kryeministër i sapozgjedhur i Kosovës, votoi në një qendër votimi në Tiranë për partinë e tij “Vetëvendosje”.

Në anën tjetër, Kurti ka akuzuar Ramën për ndërhyrje në punët e brendshme të Prishtinës, për shkak të angazhimit të Edi Ramës në dialogun me Serbinë.

Ndërsa projekti Ballkani i Hapur, solli një ndarje të theksuar mes liderëve dhe qeverive Tiranë-Prishtinë. Më 10 tetor të vitit 2019, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut miratuan një deklaratë që çoi drejt marrëveshjes për “Mini-Schengenin” ballkanik, e që më vonë u riemërua si “Ballkan i Hapur”.

Kurti – asokohe kandidat për kryeministër të Kosovës – e kundërshtoi nismën, duke thënë se Rama ka bërë gabim në hapa. Sipas tij, nisma do të duhej të ishte e Kosovës dhe Shqipërisë, për të përfshirë më pas vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, e në fund Serbinë.

Kurti dhe Rama i shprehën pub-

likisht edhe mospajtimit për çështjen e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, për formimin e të cilit komuniteti ndërkombëtar insiston në vazhdimësi.

Rama tha se ka dorëzuar një propozim të draft-statutit të këtij asociacioni të zyrtarët e lartë të BE-së, si dhe të kancelari gjerman, Olaf Scholz, dhe të presidenti francez, Emmanuel Macron – gjë që ngjalli pakënaqësi të Kurti dhe qeveria e Kosovës.

2017- Viti i krizës dhe kthesa e madhe mes Shqipërisë dhe Maqedonisë

Por nëse marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë janë tronditur pesë vitet e fundit, e kundërta ndodhi në marrëdhëniet Shqipëri-Maqedoni e Veriut, ku ka njohur një kthesë pozitive pikërisht për gjatë pesë viteve të fundit.

Për marrëdhëniet Shqipëri-Maqedoni e Veriut mund të themi shkurtimisht se deri në vitin 2017 divergjencat dhe përplasjet kanë qenë të mëdha.

Qeveria shqiptare ishte më e lidhur me partitë politike shqiptare në Maqedoni sesa me qeverinë maqedonase, qoftë VMRO apo LSDM.

Ky hendek mes dy vendeve tona ka ndodhur edhe për shkak të paqëndrueshmërisë politike në Shqipëri dhe Maqedoni. Megjithatë, ndasia mes dy vendeve ishte dhe për shkak të ndikimit në të cilën ishte Maqedonia para disa vitesh, jo vetëm nën ndikimin serb, por edhe atë të Lindjes.

Megjithatë, viti 2017 ishte kulmi i krizës, duke pasur parasysh “Platformën e Tiranës” të mbajtur në Shqipëri nën drejtimin e zotit Rama dhe akuzat e VMRO-DPMNE-së për ndërhyrje në punët e brendshme të Maqedonisë së Veriut.

Kujtojmë se në vitin 2017, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ftoi në Tiranë partitë politike shqiptare të Maqedonisë së Veriut për të biseduar lidhur me zhvillimet e asokohshme në atë shtet dhe për bashkërendimin e mundshëm të veprimeve të partive shqiptare.

Partitë shqiptare më pas dolën me një deklaratë, ku, mes tjerash, thanë se “angazhohen për ngritjen e statusit të shqiptarëve në Maqedoni [të Veriut] në popull shtet-formues – me gjuhë zyrtare, e cila do të kishte statusin e barabartë me gjuhën maqedonase – dhe për zgjidhjen e shumë çështjeve tjera etnike”.

Gjithashtu, po viti 2017 solli një kthesë të madhe mes dy vendeve tona, pasi me qeverinë e re LSDM dhe BDI, Tirana zyrtare do të kishte bashkëpunim më të

ngushtë.

Në emër të rrugës së përbashkët europiane, bashkëqeverisjes së partisë shqiptare dhe maqedonase, por edhe projektit “Ballkani i Hapur”, dy qeveritë në Shqipëri dhe RMV kanë krijuar më shumë bashkëpunime, memorandume dhe lidhje direkte mes Tiranës zyrtare dhe Shkupit zyrtar. NATO dhe BE janë dy shtylla të forta mbi të cilat mbështeten sot fuqishëm marrëdhëniet tona.

Por nuk dihet se si do vijojnë të qëndrojnë këto marrëdhënie pas 8 -majit, duke parë dhe angazhimin e Tiranës zyrtare si mbështetëse e partive politike shqiptare.

Por për sa u përket partive politike shqiptare në Maqedoni, ato janë ende një “minë me sahat” dhe “kurdisja” e saj nga jashtë rrezikon stabilitet të thellë jo vetëm në Maqedoninë e Veriut por dhe në rajon.

Ja pse ndërhyrja e Kurtit dhe e Ramës në këto zgjedhje nuk i shërbejnë partive shqiptare, madje përdorimi i tyre për interesat politike vetjake sjell një dëmtim të parikuperueshëm jo vetëm mes shqiptarëve por gjithashtu mes shqiptarëve dhe maqedonasve, të cilët ende janë në një bashkëjetesë të brishtë.

Shëmbëlltyra e Edi Ramës shpërfaqet të BDI-ja e Ali Ahmetit

Diskursi politik dhe diplomatik i Kryeminsitrit Edi Rama i shfaqur shpesh herë me folklorizma të tepruara por gjithsesi e ka bërë simpatik përballë ndërkombëtare, ka zgjuar kërshtërinë dhe të elementëve më të rëndësishëm

politik të BDI-së, si atij të Artan Grubit dhe Bujar Osmanit. Dihet se të dy janë zgjatim i kraheve të Ali Ahmetit.

Edi Rama duket se është kthyer në idhull dhe model për Partinë Demokratike për Integrim aq sa po kopjohet në detaje.

Artan Grupi ka marrë përsipër, të argetoje të rinjtë me organizmin e koncerteve të mëdha, për të përthithur kështu jo vetëm të rinjtë, por mbi të gjitha edhe artistët shqiptarë që sikundër në Tiranë janë kthyer në influencer artistiko-politik të Partisë Socialiste në Shqipëri. Mjafton të shohim dhjetra këngëtare që marrin pjesë në koncertet e organizuara nga Bashkia e Tiranës, që më pas kthehen në zëra propagandues në favor të Partisë Socialiste, konkretisht pushtetit të Edi Ramës dhe Erion Veliaj.

Artan Grubi, po ndjek me zell këtë frymë artistiko-propaganduese për elektoratin e tij në Maqedoninë e Veriut, dhe kjo vjen në mungesë të politikave konkrete social-ekonomike për të rinjtë në RMV.

Nga ana tjetër, kemi Bujar Osmanin, i cili si Ministër i Jashtëm i RMV-së pati mundësi të krijonte mbështetjen dhe kontaktet e tij ndërkombëtare që padiskutim e favorizojnë sot jo vetëm brenda partisë së tij politike por dhe përballë kundërshtarëve të tij politik.

Por dhe Bujar Osmani sytë i ka te Edi Rama, i cili çdo fundjavë vjen me podkastin e tij si intervistues i aktorëve/faktorëve të ndryshëm të suksesshëm në fusha të ndryshme në Shqipëri e diasporë.

Por nëse kryeministri Rama, e ka nisur aksionin e tij politik



si publicist në gazetat e kohës pas viti 1990, dhe është pjesë e tij edhe gazetaria, nuk mund të themi të njëjtën gjë për Bujar Osmanin.

Bujar Osmani, megjithëse mjek në profesion zgjodhi të realizojë podkaste, një risi mediatike ku të gjithë duan të bëhen gazetarë, ose me saktë protagonistë.

Ali Ahmeti dhe Edi Rama duket se janë dakordësuar për një mbështetje që iu leverdis të dyve. Ali Ahmeti kërkon mbështetjen e Edi Ramësi kryeministër i “Nënës Shqipëri”, ku ku i fundit nuk i ka ka kursyer elozhet për Ali Ahmetin.

Muajt e fundit është parë shpesh në TV kombëtare më të mëdha të Shqipërisë, duke i dhënë gjithë hapësirën për të promovuar sukseset e Ali Ahmetit.

Nga ana tjetër edhe Ali Ahmeti i ka kthyer borxhin Edi Ramës, duke e cilësuar si prijës të shqiptarëve sikundër theksoi kohë më parë në Samitin e Tretë të Diasporës.

Mos të harrojmë se Ballkani I Hapur është pika kyçe për të cilën Edi Rama i duhej desh-përimisht mbështetja e Ahmetit

ndër shqiptarë në rajon.

Një pikë e fortë që ndan dhe pik-pamjet mes Rames dhe Kurtit.

Pra, po dhe Tirana zyrtare po ndërhyr në formë më të sofistikuar në këto zgjedhje të dyfishta në Maqedoninë e Veriut.

Ballkani i Hapur, dialogu Prishtinë-Beograd janë vija të kuqe që ndajnë Kurtin me Ramën e që ndan gjithashtu Kurtin me Ahmetin.

Duket qartë se mbështetja e shqiptareve si pjesë e bashkëqeverisjes në Maqedoninë e Veriut është thelbësore si për Kurtin por dhe për Ramën.

Por çfarë interesi përbën për vetë shqiptarët dhe qytetarët e Maqedonisë së Veriut kjo ndërhyrje e Tiranës dhe Prishtinës zyrtare?

Në fakt kjo duket beteja e fundit midis Ramës dhe Kurtit dhe Maqedonia e Veriut është thjesht fushëbeteja që po luhet ky akt i fundit i kësaj drame mes vëllezërish.

Pse kjo ndërhyrje e Tiranës dhe Prishtinës nuk i shërben Maqedonisë së Veriut?

Maqedonia e Veriut është ende

peng i pretendimeve historike nga ana e Bullgarisë, ndërsa vetë rajoni në tërësi është ende i brishtë. Pa harruar sfondin gjeopolitik i cili po sjell erëra të forta destabilizimi.

Kësisoj është emergjente për Maqedoninë e Veriut që këto zgjedhje ti japin drejtimin e duhur vendit.

Shqiptarët sot janë shtetformues dhe bashkëqeverisës të këtij shtetit, ndaj në këto rrethana gjeopolitike çdo ndërhyrje nga jashtë qoftë dhe nga Shqipëria e Kosova trondit kredibilitetin e partive politike përballë qytetarëve të Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh etninë e tyre.

Që këto zgjedhje të paraqoshme, të mos prodhojnë qeveri të përkohshme në Maqedoninë e Veriut, si Tirana dhe Prishtina zyrtare duhet të ndalin këtë revansh politik gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. Përndryshe Maqedonia e Veriut do të vijojë të mbetet peng i nacionalizmave rajonale duke penguar të ardhmen e përbashkët të Ballkanit Perëndimor në familjen evropiane.

DASH: Problemet në pavarësinë e gjyqësorit dhe medias, korrupsioni, ndërhyrja e politikës, shqetësimet kryesore për Shqipërin

Sistemi gjyqësor në Shqipëri po bëhet më i pavarur falë procesit të Vetting-ut dhe veprimeve të SPAK-ut”, thuhet në raportin e publikuar sot nga Departamenti amerikan i Shtetit për të Drejtat e Njeriut.

DASH nënvizon se nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme në situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri gjatë vitit 2023. Në raport thuhet se qeveria ndërmoi hapa të besueshëm për të identifikuar dhe ndëshkuar zyrtarët që mund të kenë kryer shkelje të të drejtave të njeriut.

Lidhur me korrupsionin, Departamenti i Shtetit vë në dukje se në përgjithësi qeveria e Shqipërisë e zbatoi në mënyrë efektive legjislacionin që parashikon dënime penale për korrupsion nga zyrtarët publikë dhe që ndalon individët me dënime penale të shërbejnë si kryetarë bashkie, deputetë ose në poste të tjera qeveritare ose shtetërore, megjithatë thotë se pati raportime të shumta për korrupsion në qeveri.

“Korrupsioni ishte i pranishëm në të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes, përfshirë përmes prokurimeve publike dhe partneriteteve publike-private, megjithëse autoritetet bënë përparim gjatë vitit në luftën kundër korrupsionit dhe drejt dhënies fund të mosndëshkimit”, thuhet në raport.

DASH- përmend arrestimet e nivelit të lartë nga SPAK-u dhe dënimet për raste korrupsioni, përfshirë dënimet për korrupsion dhe shpërdorim detyre të ish-ministrit të Mjedisit Lefter Koka dhe ish-sekretarit të tij të përgjithshëm Alqi Bllako.

“Në korrik SPAK-u lëshoi një urdhërarrestimi ndërkombëtar për ish-zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Financave (dhe deputet i Partisë Socialiste) Arben Ahmetaj. Ai u largua nga vendi



pasi parlamenti pranoi kërkesën e SPAK-ut për heqjen e imunitetit të Ahmetajt që ai të mund të arrestohej me akuzat për korrupsion, pas trim parash dhe fshehje pasurie”, thuhet në raport.

Në raport përmendet gjithashtu rasti i ish-kryeministrit Sali Berisha. “Në tetor, SPAK njoftoi se po hetonte zyrtarisht ish-kryeministrin Sali Berisha për korrupsion pasiv lidhur me një marrëveshje toke nga e cila dhëndri i tij përfitoi rreth 5 milionë dollarë. SPAK arrestoi dhëndrin e Berishës, urdhëroi Berishën të paraqitej rregullisht në policinë gjyqësore dhe i ndaloi daljen nga vendi”, thotë DASH-i.

“Megjithëse Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, presioni politik, frikësimi, korrupsioni dhe burimet e kufizuara e penguan gjyqësorin të funksiononte plotësisht, në mënyrë të pavarur dhe efikase”, thuhet në raportin e Departamentit të Shtetit.

DASH shton më tej se vazhdoi zbatimi i procesit të vetting-ut për gjyqtarët dhe prokurororët, në mënyrë që të përjashtoheshin nga sistemi ata që kishin pasuri të pashpjegueshme, ose lidhje me krimin e

organizuar.

“Avokati i Popullit vlerësoi se gjyqësori kishte bërë përparim drejt krijimit të një sistemi më të pavarur, por shtoi se nevojiteshin më shumë burime”, thotë raporti.

Sipas raportit sistemi gjyqësor po bëhet më i pavarur falë procesit të vettingut dhe veprimeve të SPAK-ut, megjithatë vihet në dukje se qytetarët janë ankuar për mungesë transparence në hetime, zvarritje të konsiderueshme të proceseve dhe vendime të padrejta gjyqësore.

Departamenti i Shtetit thotë se Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe publik, dhe se gjyqësori në përgjithësi e zbatoi këtë të drejtë.

“Komiteti Shqiptar i Helsinkit vuri në dukje se çështjet e prapambetura të grumbulluara, vendet vakante në gjyqësor dhe mungesa sistematike e efikasitetit, minuan besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë”, thuhet në raport.

Shumica e ankesave nga qytetarët kishte të bënte me mungesën e përgjigjes nga organet qeveritare ndaj shqetësimeve të tyre, shkeljet e procesit të rregullt ligjor, gjykimet dhe dënimet e padrejta. /VOA/

SPECIALE

Nga nderimet ushtarake te marrëveshjet Shqipëri-Francë gjatë vizitës zyrtare të Ramës në “Elyse”



Kryeministri Edi Rama, në një vizitë zyrtare në Francë me ftesë të presidentit Emmanuel Macron, u prit më 12 prill 2024 me nderimet me të larta ushtarake, duke u bërë kështu kryeministri i parë shqiptarë që pritet me nderime ushtarake në Oborrin e Nderit të ‘Les Invalides’.

Në ditën e dytë të vizitës së tij në Francë, Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga bashkëshortja Linda Rama u nderua në ceremoninë e mbajtur në Oborrin e Nderit të “Les Invalides”, në Paris, një kompleks i mirënjohur muzeal dhe monumentesh, të lidhura me historinë ushtarake e

Francës.

Kryeministri Rama dhe bashkëshortja u pritën në portikun e hyrjes nga Ministri për Europën Jean-Noël Barrot dhe nga Gubernatori Ushtarak i Parisit, Gjeneral korparmata Christophe Abad. Më pas, Kryeministri, i shoqëruar nga Komandanti i trupës së Gardës Republikane, përshkoi Oborrin e Nderit, në prezencën tri togave të rreshtuara të Gardës.

Himnet kombëtare të Shqipërisë dhe Francës vijuan protokollin e ceremonisë e më tej Kryeministri Rama i shoqëruar nga Komandanti i Trupës parakaloi para togave të Gardës.

Nderimet ushtarake para Kryeministrit Rama u paraqiten nga një detashment i përbërë nga orkestra e Gardës Republikane dhe tri toga te regjimenteve të Këmbësorisë së Gardës Republikane.

Pas nderimeve ushtarake në Ceremonialin shtetëror, Kryeministri Rama, u mikprit në Pallatin Elysee, nga Presidenti francez Emmanuel Macron, i cili shoqëroi Kryeministrin Rama në ambientet e brendshme të Pallatit, ku u prezantuan delegacionet respektive e më pas dhanë një deklaratë për shtyp për mediat e pranishme.

Rama u shpreh se ndihej shumë

krenar për Shqipërinë dhe miqësinë me Francën pasi ishte hera e parë që një përfaqësues i shtetit shqiptar të pritej në këtë mënyrë.

“Po vij nga një përvojë e dendur para disa minutash, një ceremoni që s’e kisha imagjinuar kurrë në jetën time, që u nënshkrua me mbërritjen time në Francë në fillim të viteve ’90. Kur vija nga aeroporti, mbajta radhën gjatë për të gjetur një taksì, pastaj jetova ato vështirësi të mëdha të asaj kohe për të gjithë ata dhe ato që vinin nga Shqipëria, që kishin një pasaportë shqiptare sepse Europa nuk ishte e lehtë për ne në ato kohë. Pastaj mendoja se kisha parë gjithçka kur mbërrita një ditë i shoqëruar për të ardhur në këtë pallat për të marrë Legjionin e Nderit, por sot jam vërtetë shumë krenar, jo për veten, por krenar për Shqipërinë, për këtë miqësi mes Shqipërisë dhe Francës sepse

ishte hera e parë në historinë tonë të marrëdhënieve diplomatike që një përfaqësues i shtetit shqiptar të pritej në këtë mënyrë dhe të falënderoj me gjithë zemër sepse kjo do të thotë vërtetë shumë për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe për më tepër, – këtu bëme pak shaka me ambasadorin sepse ishte një grup njerëzish, një ekip miqsh të Shqipërisë që asokohe në vitet ’90 ishin një numër shumë i vogël sa gishtat e një dore, – sot janë shumë më tepër, sot ka njerëz të shumtë që janë në Shqipëri për të investuar, për të zgjeruar ndërmarrjet e tyre dhe vërtet ky është një revolucion.

Dua të të falënderoj veçanërisht për dy gjëra; së pari për vizionin, vendosmërinë më të cilin e ke nditur, e ke shtyrë këtyre valë të re të afrimit ndërmjet vendeve të Ballkanit dhe Bashkimit Europian, duke vënë në tryezë nevojën për ta shoqëruar këtë proces in-

tegrimi me një proces përafrimi përtej rrugëve burokratike të çdo vendi.

Ne jemi sot dëshmitarë të rezultateve për Shqipërinë, për të gjitha vendet e Ballkanit dhe Plani ynë i rritjes, që u miratua nga Parlamenti Europian është diçka që shkon në këtë drejtim, një Europë e fortë, një Europë e bashkuar, një Europë që nuk mbetet peng i mënyrave të vjetra, i metodave të vjetra tradicionale të integritimit, kur ka diçka apo asgjë.

“Sot jemi në një situatë krejt të ndryshme, shumë më pozitive dhe nga ana tjetër dua të falënderoj edhe për vizitën në Shqipëri, sepse përtej vizitës, përtej kuptimit të sensit historik të vizitës, përtej momenteve shumë të bukura që kaluam së bashku ka patur një vijim, një vijim që na ka prekur dhe na ka habitur shumë, sepse janë gjëra që po ndodhin, ka projekte, ka gjëra që po marrin formë, është ekselencia franceze që po mbërrin në Shqipëri dhe tani kemi një horizont të ri, një horizont të ri të punës së përbashkët, ku kanë nisur investime të mëdha për njohjen dhe financimin francez për dy paraqet fotovoltaike të rajonit.

Faleminderit me gjithë zemër në emër të të gjithëve, të të gjithë shqiptarëve që për të thënë të vërtetën kanë qenë disi skeptik në lidhje me Francën para disa viteve, por sot ata e kuptojnë se Shqipëria ka një mik tjetër të afërt dhe ne shqiptarët nuk jemi të pasur, nuk jemi të mëdhenj, por ne kemi aftësi, ne kemi një aftësi besnikërie unike. Pra nëse një ditë do të jeni nevojë për dikë për të qenë me ju në një moment vështirësie të jashtëzakonshme, thirrni një shqiptar ai do të vijë“, tha Rama.



EMMANUEL MACRON: MBËSHTETJE SHQIPËRISË PËR INTEGRIMIN EVROPIAN, TË IMPRESIONUAR NGA TËRËSIA E REFORMAVE



Presidenti francez Emmanuel Macron nga ana e tij përsëriti angazhimin e Francës në favor të angazhimit evropian të Shqipërisë. Në konferencën e përbashkët për shtyp me Kryeministrin Edi Rama, Macron tha se “jemi këtu sot se Franca ju do, ju dhe vendin tuaj. Kisha shumë dëshirë t’ju prisja në Paris pas pritjes që më bëtë tetorin e vitit të kaluar pas vizitës së parë të Presidentit të Republikës të Francës në Shqipëri që prej pavarësisë së Shqipërisë në 1912. Këto dy vizita të kryqëzuara dhe dialogu që ne kemi me njëri-tjetrin dëshmojnë për dinamikën e jashtëzakonshme që ne kemi ndërmjet Shqipërisë dhe Francës”.

“Ju e dini se mund të keni besim

tek vendosmëria ime për t’i intensifikuar edhe më shumë. Siç e nënvizova para 6 muajve në Tiranë këtu bëhet fjalë vetëm për bashkimin e Europës për ta bërë më të fortë, më sovranë në kontekstin e agresionit rus kundër Ukrainës, por gjithashtu përballë kërcënimeve dhe sfidave të përbashkëta. Është gjithashtu një premtim paqeje për të gjithë rajonin”, nënvizoi Macron.

Më pas, në praninë e dy krerëve të qeverive u nënshkruan marrëveshje ndërqeveritare bashkëpunimi mes vendeve, përkatësisht:

- Marrëveshje Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së

Francës mbi Kontributin në Zbatimin e Projekteve Prioritare në Shqipëri. Marrëveshja u nënshkrua nga nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Blendi Gonxhe dhe Ministri i Deleguar për Europën, Jean-Noël.

- Marrëveshje e Huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Një Hua për Politikë Publike për të mbështetur Aftësinë Përtëritëse dhe Zhvillimin e Gjellbër të Shqipërisë. Marrëveshja u nënshkrua nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Blendi Gonxhe dhe zv/Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë Franceze të Zhvillimit (AFD), znj. Marie-Hélène Loison.

Parlamenti Evropian miraton planin prej 6 miliardë eurosh për Ballkanin Perëndimor

Parlamenti Evropian e ka miratuar të mërkurën planin për rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor, në vlerë prej 6 miliardë eurosh, në seancën e parafundit të saj para zgjedhjeve të reja në BE në qershor.

Kjo është një prej paketave më ambicioze të Bashkimi Evropian për ta ndihmuar rritjen ekonomike dhe reformat në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që ato të ecin përpara më shpejt drejt integritimit të plotë në bllok, shkruan REL

Tani, pasi Parlamenti Evropian e miratoi paketën, ajo duhet të formalizohet edhe nga Këshilli i BE-së. Pas kësaj, mund të fillojnë pagesat e para për përfituesit.

Paketa përmban 6 miliardë euro, prej të cilave vendet e Ballkanit Perëndimor do t'i marrin 2 miliardë euro në formën e parave të gatshme pa kthim, ndërsa 4 miliardë euro në formën e kredive të favorshme. Sipas marrëveshjes mes Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, e cila është përfshirë në tekstin e rezolutës së sotme në Parlament, për të përfituar nga kjo ndihmë financiare, vendet e rajonit duhet të përmbushin një varg kriteresh jo edhe aq të lehta. Në mesin e tyre janë kriteret bazike, të cilat vlejné njëlloj për të gjitha vendet anëtare. Ato kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, respektimin e parimeve të demokracisë, reformat institucionale dhe ndërmarrjen e hapave të domosdoshëm për të garantuar se mjetet nuk do të keqpërdoren.

Pos kriterëve që kanë të bëjnë me reforma dhe sundimin e ligjit, ka edhe kriteret e natyrës politike.

Për Kosovën dhe Serbinë parakusht tjetër do të jetë angazhimi konstruktiv në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Vlerësimet se a e përmbushin apo jo këtë kriter Kosova apo Serbia do ta japë Komisioni Evropian, i cili – i ndihmuar nga Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian (EEAS), që edhe luan rolin kryesor në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë – do të vlerësojë në fund nëse Kosova dhe Serbia e kanë plotësuar këtë parakusht.

Parlamenti Evropian, edhe përmes vendimit të sotëm, kërkon nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor t'i përshtatin politikën e tyre të jashtme me vendimet e BE-së, përfshirë edhe me sanksionet kundër Rusisë. Por, gjatë negociatave me Këshillin



ka pasur mospajtime nëse ky duhet të jetë kusht specifik apo jo për pagesat nga plani evropian për rritje ekonomike.

Ka dominuar qëndrimi i Komisionit Evropian dhe një numri më të madh të shteteve anëtare se ky nuk duhet të jetë parakusht specifik, por vetëm qëllim i përgjithshëm.

Vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat do të përfitojnë nga kjo ndihmë, duhet të kenë plane operative për reforma dhe t'i bashkërendojnë ato me Komisionin Evropian. Në vendimet finale për pagesat do të përfshihen Komisioni Evropian dhe vendet anëtare të BE-së përmes Këshillit.

Kërkohet edhe transparencë në procesin e prokurimit dhe hetime serioze në rastet e shkeljes së rregullave, apo në rast mashtrimesh. Për rastet e keqpërdorimeve kërkohet të njoftohen Zyra e Prokurorisë Publike të BE-së, dhe Zyra e BE-së për Parandalimin e Mashtrimeve (OLAFD).

Parlamenti Evropian ka ngulur këmbë që kjo paketë të jetë e veçantë dhe të mos jetë pjesë e Instrumenteve të Para-Anëtarësimit (IPA), të cilat janë fonde të rregullta të BE-së për vendet e përfshira në procesin e zgjerimit.

Këto gjashtë miliardë euro shtesë për vendet e Ballkanit do të jenë për periudhën kohore prej vitit 2024 deri në vitin 2027, sa edhe zgjat korniza aktuale shumëvjeçare financiare e Bashkimit Evropian.

“As i gjallë as i vdekur”! “Oksigjen” për ekonominë gjermane! Plot vizita dhe samite po produkti? Autonomi strategjike europiane! Shqipërinë nuk e mbron vetëm Kryeministri!

REALPOLITIK FLASH NR. 88 | 1 - 30 PRILL 2024 | EKSLUZIVISHT PËR ARGUMENTUM

Mbi 5 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, me vetëm 1.000 fjalë nga analisti i njohur



DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Asi gjallë as i vdekur! Këtë mund të themi për takimet në Bruksel në kuadrin e dialogut Beograd – Prishtinë. Siç përmendëm dhe radhën e kaluar ato praktikisht po bëhen thjesht “për t’u gjind Kola në punë”. Sidomos këtë vit nuk e ka kush merakun te dialogu, por te çështje të

mëdha të mprehta politike, të cilat do të përcaktojnë dhe vetë fatin e dialogut! Mbi të gjitha janë zgjedhjet përcaktuese në BE, SHBA, dhe gjatë. Pastaj, kundërshtimi agresiv serb ndaj anëtarësimit të Kosovës në KiE mund ta zhvleftësojë si dialogun e deritanishëm ashtu dhe Marrëveshjen e Ohrit. Ja pse ky dialog nuk është “as në qiell as në tokë”, as i gjallë as i vdekur”. Ndaj, le të presim vitin 2025, ama me një strategji të tërësisht të ndryshme dhe cilësore Perën-

dimore, me ndërmjetësues të rinj e me mendësi të tjera!

2.

Oksigjen për ekonominë gjermane! Këtë fakt e rikonfirmoi dhe vizita tre ditore e Kancelarit gjerman Olaf Scholz në Kinë (14 – 16 Prill).

Gjatë takimit me Presidentin Xi Jinping, ky i fundit përsëriti mesazhin e Samitit BE – Kinë dhjetorin e kaluar në Pekin se “ndarja” e marrëdhënieve me



Kinën dhe de-riskimi nuk janë opsione realiste dhe produktive. Po ashtu ai theksoi se “ Marrëdhëniet me Kinën nuk janë risk, por shans dhe mundësi zhvillimi”.

Vitin e kaluar Berlini zyrtar miratoi strategjinë e re me Kinën, ku theksohet se politika e jashtme do të mbështetet në vlera dhe parime”. Ndonëse kjo tingëllon muzikë, zbatimi i saj në praktikë dhe veçanërisht në fushën jetike ekonomike dhe të investimeve dypalëshe është pothuajse i pamundur.

Ndaj Kancelari Scholz e nisi vizitën tre ditore në Kinë në Schongqing tregtar, ndër qytetet më të mëdha të botës me 32 milion banorë, ku janë aktive 84 kompani gjermane, vijoi në Shangain ekonomik dhe përfundoi në Pekinin politik. Në vizitën e tij të dytë brenda 2 viteve, ndërsa paraardhësja e tij, Kancelarja Merkel ishte atje 14 herë në 16 vite në pushtet!

Chancellor Olaf Scholz makes a statement on the situation in Israel and his trip through China. The Chancellor’s trip to Chongqing, Shanghai and Beijing will focus on economic relations with the world’s second largest economy, the war in

Ukraine, the conflict over Taiwan and the human rights situation in China. Photo: Michael Kappeler/dpa

Tani, sa për varësinë e madhe ekonomike gjermane nga Kina, fajin asaj nuk ia ka kush. Ndonëse dhe përfitimet gjermane janë të majme. Kështu, më 2019, eksportet gjermane në Kinë përfaqësuan 48,5 për qind të eksporteve europiane; ekonomia për gjermanët tani është kthyer në faktorin vendimtar për mbijetesën qeveritare dhe suksesin zgjedhor. Gjatë vitit 2023 rritja ekonomike gjermane ishte 0,1 nga 1, 3 për qind e parashikuar, ndërsa ajo ekonomia kineze u rrit 5,3 nga 4,5 për qind e parashikuar. Për të tetin vit rresht, Kina është partneri më i madh tregtar për Gjermaninë. Rrjedhimisht, pa eksporte dhe investime në Kinë, ekonomia gjermane ka pak shanse të mbijetojë.

Faktikisht, e “vërteta e shëmtuar” është se vitet e fundit, megjithë debatet mbi fatet e bashkëpunimit ekonomik me Kinën, në përgjithësi, fuqia gjermane është e lidhur ngushtë me marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me Kinën. Pa të ekonomia gjermane gëc në baltë.

3.

Autonomi strategjike:

Si gjatë vizitës në Pekin vitin e kaluar, ashtu dhe më 25 Prill, në fjalën në Universitetin e famshëm të Sorbonës, Presidenti francez Macron kërkoi forcimin e marrëdhënieve ndër-europiane, pa dëmtuar por dhe pa qenë të varur totalisht nga aleanca me SHBA-të. Mbi të gjitha ai i mëshoi fort tezës mbi “ autonominë strategjike europiane”; duke u shprehur kundër krizave që nuk i takojnë Europës dhe që pengojnë funksionimin e kësaj autonomie”. Këtë ide e konkretizoi më mirë me disa propozime konkrete në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Vetëm se siç thotë populli, “nga e thëna te e bëma ndan një det i tërë”

Fjala e Macron në Sorbonë është vijim dhe plotësim i vizionit të tij mbi një Europë të re, të fortë, të bashkuar dhe autonome në vendimet e saj gjeopolitike nga SHBA-të. Por dhe një masë për të shmangur një fitore të mundshme të nationalistwve tw Le Penit në zgjedhjet europiane më 9 Qershor.



4.

Samite dhe vizita, po produkti? Për të dytën herë brenda 9 muajve, 5 muaj mbas takimit Xi Jinping – Biden në Uashington dhe vizitave të emisarëve të tjerë të lartë amerikane Sekretari Blinken ishte më 23 – 25 Prill në Kinë. Nisur nga rezultatet e njohura tashmë, sërish politika amerikane me Kinën nuk ecën, dhe nuk ka shanse të eci, pa patur e zbatuar një strategji të qartë, “me këmbë në tokë” e të mirëmenduar, përpara se të vendosen sanksione dhe

ndëshkime. Kujdes, ke të bësh me një vend gjigand që “të bën gjëmën”! Ca më tepër kur nuk po të dëgjojnë fjalën as Izraeli dhe të tjerë më të vegjël! Mesa duket, SHBA-ve u mungon një kryestrateg diplomatik si Kissingeri. Ndërsa Kina po e shfrytëzon shumë mirë situatën, si me SHBA-të ashtu dhe me Rusinë; duke i thënë kësaj të fundit, kujdes, se shih çfarë haraçi të madh po paguaj! Shkurt hesapi, mirë bëjnë që venë e vijnë, ca në Pekin dhe në Uashington, por produkti nuk po duket gjëkund; sepse ai kërkon strategji dhe



plane të efektshme veprimi, kërkon takat e jo inat”. Le të shpresojmë.

5.

Shqipërinë nuk e mbron vetëm Kryeministri! Këto ditë po diskutohet shumë mbi reagimet e Kryeministrit Rama ndaj RAI3. Nuk kemi gjë kundër, por shqetësimi është se Kryeministri është për të qeverisur e jo për të dhënë opinione, për të komentuar, për të bërë zëdhënësin dhe as për “luftë” fjalësh me televizionet e vendit e ca me pak të huajat! Ndryshe, çmund të ndodhte sikur disa televizione ndërkombëtare të jepnin dokumentarë si RAI 3, si do t’i shkonte halli me Kryeministrin tonë? Ndaj, zgjidhja më e mirë do të ishte që në vend të tij, të dilte zëdhënësi ose Agjencia e Medias e të përgënjeshtroinin, me gjuhë të fortë por të kulturuar dhe nëse nuk do të ndodhte kjo, atëhere çështja të shkonte në gjykatë. Dhe aq.

Themi kështu sepse Kryeministri ka një sistem të tërë institucional që duhet të bëjnë punën e tyre, pa djegur hierarkinë shtetërore dhe pa telefonata kryeministrore për televizionet e huaja. Ndryshonte puna po të kishim të bënë jo me RAI 3, por me kryeministrin e një vendi të huaj, atëhere po. Sepse është e pamundur për një kryeministër t’u japë përgjigje të gjithëve, brenda dhe jashtë, ditë dhe natën; sepse nuk ka kohë, kuptim, mundësi dhe rezultat! Shqipërinë e mbron gjithkush e jo vetëm Kryeministri! ”Vaj hallit” po të ishte kjo e fundit!

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË RMV

Ku ndahen dhe ku bashkohen partitë politike shqiptare dhe maqedonase



Ndërsa fushata elektorale për zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut u mbyll zyrtarisht të hënën (22.04) dhe kur tashmë janë të njohura qëndrimet dhe zotimet e tyre përballë elektoratit, në këtë analizë do të pasqyrojmë të gjitha ndasitë dhe pikat përbashkuese të kandidatëve për president të Maqedonisë së Veriut.

Përkundrejt koalicioneve të mëdha që u krijuan si nga partitë politike shqiptare dhe ato maqedonase, në garë për kreun e shtetit janë jo pak por shtatë kandidatë që vijnë nga katër koalicione dhe tri parti politike. Një garë që trupëzon jo vetëm

votat por dhe qëllimin e saj. Ndonëse në fokus ka zgjedhjen e Presidentit të ri të Maqedonisë së Veriut, njëkohësisht nëpërmjet raundit të parë të zgjedhjes së presidentit, do të shohim dhe kahjen e votës që do të përcaktojë dhe kryeministrin e ri në zgjedhjet parlamentare që do zhvillohen në 8 maj.

Por le të qëndrojmë konkretisht te fushata presidenciale.

Emra të njohur dhe të panjohur, u rrjeshtuan si kandidatë për kreun e ri të shtetit. Ata që janë ballafaquar edhe më parë në garën presidenciale janë kandidatet e VMRO-DPMNE dhe LSDM-së, përkatësisht Stevo Pendarovski përballë Gordana

Siljanovska Davkova, Presidenti aktual, Stevo Pendarovski, garon për një mandat të dytë me propozim të Lidhjes Social-Demokrate në pushtet, që është në koalicion me disa parti të tjera politike.

Gordana Siljanovska Davkova, ndonëse thotë se është kandidate e pavarur, ajo është gjithashtu e vetmja kandidate e VMRO-DPMNE-së.

Beteja për president nuk është vetëm mes dy partive të mëdha maqedonase por dhe ndërmjet dy kampeve të mëdha të partive shqiptare. Konkretisht Bujar Osmani nga "Fronti Evropian", që udhëhiqet nga Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)

dhe Arben Taravari, kandidat i koalicionit “VLEN”, që përbëhet nga katër parti opozitare shqiptare.

Kandidatë për president janë edhe Maksim Dimitrievski, kryetar i Kumanovës, Stevçe Jakimovski, kryetar i Karposhit në Shkup dhe Biljana Vankovska, kandidate e partisë E Maja.

Një fushatë elektorale atipike, që më shumë se sa për institucionin presidencial, partitë politike respektive, e kanë përdorur këtë fushatë, si burim votash për zgjedhjet parlamentare madje disa syresh kanë përfshirë dhe politikën rajonale e globale si pjesë e diskursit politik gjatë kësaj fushate.

Pra kandidatët për president kanë folur edhe për çështje që nuk janë në fushën e tyre, si çështjet e politikës së jashtme, integrimin e vendit në Bashkimin Evropian, sundimin e ligjit, forcimin e demokracisë etj.

Kujtojmë se Presidenti në Maqedoninë e Veriut ka kompetenca të kufizuara. Ai është komandant i përgjithshëm i Armatës, dekreton mandatarin për formimin e qeverisë dhe të ambasadorëve jashtë vendit, bën disa emërimë në organet gjyqësore dhe në organet e sigurisë, por ata duhet të miratohen edhe në Kuvend.

Por siç e kemi parë narrativen e kësaj fushate presidenciale që prej 4 prillit, ka tejkaluar çdo kompetencë që një president mund të ketë. Madje në disa tubime elektorale, i kalon dhe kompetencat e vete shtetit maqedonas, ndërsa disa kandidatë merrnin përsipër të ishin pjesë e zgjidhjes përballë sfidave gjeopolitike rajonale e ndërkombëtare.

”
Ndryshimet kushtetuese për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, Kosova, Influenca ruse-serbe, Marrëveshja e Prespës, Nisma “Ballkani i Hapur”, janë disa nga pikat ndarëse dhe përbashkuese të koalicioneve dhe partive politike shqiptaro-maqedonase. Kjo fushatë elektorale përgjatë tre javëve u dominua gjithashtu me akuza e kundërakuza ndaj njëra-tjetrës për “tradhti” dhe “politikë anti-perëndimore dhe pro-ruse”.

Por ku ndahen dhe ku bashkohen partitë politike shqiptare dhe maqedonase në zotimet e tyre elektorale?

Ndryshimet kushtetuese për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, Kosova, Influenca ruse-serbe, Marrëveshja e Prespës, Nisma “Ballkani i Hapur”, janë disa nga pikat ndarëse dhe përbashkuese të koalicioneve dhe partive politike shqiptaro-maqedonase. Kjo fushatë elektorale përgjatë tre javëve u dominua gjithashtu me akuza e kundërakuza ndaj njëra-tjetrës për “tradhti” dhe “politikë anti-perëndimore dhe pro-ruse”.

Po le të shohim se si janë rrjestuar kandidatët për president përballë këtij diskursi publik;

Ndryshimet Kushtetuese, vija e kuqe që ndan dhe bashkon kampet kryesore politike

Sa i përket ndryshimeve kushtetuese, që në fakt ishin shkaku që çoi qeverinë LSDM-BDI në zgjedhje të parakohshme parlamentare, ato u bënë kryefjalë e fushatës elektorale presidenciale. Ndryshimet kushtetuese bashkojnë LSDM, dhe dy kampet e mëdha politike shqiptare, koalicioni “Fronti Europian”

dhe “VLEN”. Në fakt kjo është e vetmja pikë që bashkon dhe vetë shqiptarët, të cilët duken të vendosur për të përmbushur kushtin e BE-së për integrimin evropian.

Ndryshe nga deklaratimet e VMRO-DPMNE apo nga kandidatja e “E Maja” që këto ndryshime kushtetuese i shohin si tradhëti ndaj atdheut dhe e kundërshtojnë me bindje para elektoratit të tyre, në fakt, Mickovski, kryetari i VMRO-DPMNE, e ka zbutur pak tonin kundërshtues ndaj ndryshimeve kushtetuese, pasi ai thekson se këto ndryshime duhet të vijne nën kushte e rrethana të tjera.

Hristijan Mickovski, kryetari i VMRO DPMNE-së dhe kandidat për kryeministër i kësaj partie në zgjedhjet e ardhshme, ka thënë se partia e tij “pas fitores në zgjedhje” do të arrijë të sigurojë marrëveshje me të favorshme dhe pa kushte të reja nga Bullgaria, që do t’i hapin rrugën procesit integrues.

Gjithashtu, kandidatja për presidente e VMRO-DPMNE, Gordana Silanovska-Davkova, është kundër ndryshimeve kushtetuese, që janë kusht në procesin e integritit të këtij vendi në Bashkimin Evropian, por

në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Silanovska-Davkova tha se nëse përbërja e re parlamentare do t'i votonte ndryshimet kushtetuese, ajo do ta respektonte një vendim të tillë, pavarësisht se nuk do të pajtohej me të.

Kosova/ Bujar Osmani përdor funksionin e tij zyrtar si Minister i Jashtëm

Kosova, tensionet me Serbinë, janë bërë gjithashtu kryefjalë e fushatës për zgjedhjet presidenciale që në thelb duket tejet absurde.

Kjo u vu re që në javën e parë të fillimit të fushatës presidenciale, ku kandidati për president i koalicionit "Fronti European" Bujar Osmani, deklaroi se derisa ka qenë kryesues i OSBE-së, ka dalë me plan 9 pikësh për deeskalimin e situatës në veri të Kosovës, gjatë muajit qershor të vitit të kaluar. Plani, sipas Osmanit, më pas është bërë pjesë e Qeverisë.

Kjo deklaratë ka përplasur ashpër Taravarin me Osmanin.

Kandidati për president nga radhët e "VLEN", Arben Taravari, deklaroi se është tronditur me informatën nga zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, se Bujar Osmani ka qenë hartues i planit 9 pikësh nga OSBE për deeskalimin dhe normalizimin e situatës në Veriun e Kosovës, i cili parashikonte tërheqjen e forcave speciale të Kosovës nga Veriu, dorëheqjen e kryetarëve të zgjedhur në katër komuna të veriut, ndërkaq për sigurinë e qytetarëve të kujdesej policia e rregullt.

A është koncepti juaj për paqen, hapja e rrugës për terroristët dhe cenimi i sovranitetit të Kosovës?", tha Arben Taravari.

Kosova është vija e kuqe mes Osmanit dhe Taravarit, edhe sepse ky i fundit dhe koalicioni i tij qartësisht kanë marrë bekimin e Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Megjithatë përfshirja e situatës së Kosovës në këtë fushatë është e papërgjegjshme nga të gjitha palët.

"Ballkani i Hapur". A do të largohet Maqedonia e Veriut nga kjo nismë?

Opozita shqiptare e bashkuar në koalicionin "VLEN" me kandidat për president Arben Taravarin, që në krye të herës janë deklaruar kundër kësaj nisme, e cila sipas tij cenon drejtpërdrejt Kosovën, duke e quajtur nismë ruso-serbe që nuk i sjell asnjë të mirë shqiptarëve.

Si premtim, Taravari ka theksuar daljen menjëherë nga kjo nismë. Ndërkohë LSDM-BDI, si bashkëqeverisëse kanë bashkëpunuar ngushtë për implementimin e saj bashkë me Tiranën dhe Beogradin.

Megjithatë, Bujar Osmani, deklaroi papritur se Maqedonia e Veriut do ta shqyrtojë largimin nga nisma "Ballkani i Hapur", në fakt kjo deklaratë u anatemua menjëherë nga qeveria e Maqedonisë së Veriut ku shprehen se

"në Qeveri ende nuk ka arritur një kërkesë e tillë nga MPJ-ja për t'u diskutuar nga ekzekutivi", duke sjellë në pamje të parë një përplasje mes dy ish-bashkëqeverisësit LSDM-BDI.

Ndikimi ruso-serb versus-shqiptar (Tirana-Prishtina)

Një nga tezat më të fuqishme që është shpалosur gjatë fushatës për zgjedhjet presidenciale, ka qenë influenza ruse dhe serbe. Agresioni rus ka qenë retorike e Ali Ahmetit dhe "Frontit European" gjatë kësaj fushate presidenciale çka ka sjell jo pak habi si brenda dhe jashtë vendit, Kandidati për president i koalicionit "Fronti European" duke përdorur sërish funksionin e tij si Ministër i Jashtëm flet për rreziqet ruse, jo vetëm për Maqedoninë e Veriut, por edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor, dhe këto të dhëna thotë se i ka nga qasja që gëzon në informacionet e aleancës veri-atlantike, NATO-s.

Ai theksonte se kërcënimet ruse mund të kenë pasoja mbi marrëdhëniet ndëretnike, që janë shtylla e stabilitetit dhe e sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Megjithatë nuk ka ende asnjë indicie reale për kërcënim të sig-

Një nga tezat më të fuqishme që është shpалosur gjatë fushatës për zgjedhjet presidenciale, ka qenë influenza ruse dhe serbe. Agresioni rus ka qenë retorike e Ali Ahmetit dhe "Frontit European" gjatë kësaj fushate presidenciale çka ka sjell jo pak habi si brenda dhe jashtë vendit.

urisë nga Rusia apo ndërhyrje në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të Maqedonisë së Veriut. Ndaj dhe ky slogan i Ahmetit është më shumë për tu përfshirë në vorbullen gjeopolitike, pasi tani në arenën ndërkombëtare Rusia është shteti malinj, por asgjë më shumë.

Ndërsa nga koalicioni "VLEN", vijon theksi Serbi-Kosovë.

Kandidati i VLEN-it për president, Arben Taravari bashkë me liderët e koalicionit VLEN, në një tubim në diasporë (19-20 prill) tha: "Maqedonia në këto zgjedhje është para një udhëkryqi shumë të rëndësishëm. Zgjedhjet janë historike për shkak se baza e garës politike e Maqedonisë, në qoftë se e thjeshtëzojmë, del se garon Albinizmi kundrejt Vuçizmit.

Një togfjalësh që tregon se Maqedonia e Veriut mund të jetë fushëbeteja e radhës mes Kurtit dhe Vuçiqit.

Lidhur me ketë pikë, partitë maqedonase kanë bërë një hap pas, duke mos përfshirë akuzat për ndikim rus apo serb edhe për vetë linjën politiko-historike të Maqedonisë dhe partive maqedonase, ndonëse kanë kundërshtuar ndikimin dhe mbështjen e hapur që është parë nga Tira-

na dhe Prishtina zyrtare në këtë fushatë.

Marrëveshja e Prespës përplasia LSDM-VMRO-DPMNE

Një tjetër pikë me rëndësi në këtë ballafaqim elektoral, është ajo mes dy partive më të mëdha maqedonase, LSDM-VMRO, lidhur me një marrëveshje historike, që i hapi rrugën integritimit europian të Maqedonisë dhe anëtarësimit të saj në NATO.

Marrëveshja e Prespës, çuditërisht u kthye në vëmendje gjatë fushatës, edhe pse nuk ka më vend për diskutim të saj.

Gjithsesi kandidatja për presidente e VMRO-DPMNE por dhe kandidatja nga Partia "E Maja" e konsiderojnë akoma të hapur edhe Marrëveshjen e Prespës, që ka të bëjë me ndryshimin e emrit të Maqedonisë në Maqedoni të Veriut, dhe që i hapi rrugën këtij vendi për anëtarësim në NATO.

"Kur them se është çështje e hapur, këtë e bazoj në pakicën maqedonase që jeton atje. Më shpjegoni se si mund të themi se vetëm ne nuk kemi pakicë në Greqi, kur atje kemi shoqatën maqedonase "Vinozhito", theksonte Davkova.

E njëjta retorikë politike kundër kësaj marrëveshje u përdor fort nga Mitsotakis, si lider i opozitës

në atë kohë, por si kryeministër i Greqisë ai u shpreh se, "Marrëveshja e Prespës duhet respektuar, pasi përfaqëson një marrëveshje të shtetit grek."

Kujtojmë gjithashtu se lidhur me Marrëveshjen e Prespës, Presidenti i SHBA-së, Joe Biden, në vitin 2021 nënshkroi urdhër ekzekutiv, me të cilin u parapngridja e pronës dhe ndalesë për hlyrje në SHBA të personave të cilët punojnë kundër Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes së Ohrit.

Të gjitha partitë politike e dinë mirë që nuk ka kthim pas, e megjithatë e përdorin si retorikë boshe përballë elektoratit të tyre.

Po qytetarët?

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh etninë e tyre, më shumë se asnjëherë janë të bombarduar nga retorika boshe dhe folklorizëm politik. Asnjë premtim apo zotim i drejtpërdrejtë që ka në prioritet qytetarin, ndoshta edhe për shkak të funksioneve të kufizuara që ka institucioni i presidencës.

Megjithatë, vlen të theksohet se edhe njëherë kjo fushatë u shoqërua nga nota nacionaliste. Por sot në vitin 2024 të shek XXI shoqëria shqiptaro-maqedonase kërkon pajtim dhe jo ndasi etnike. Politikanët e të dyja palëve politike, qofshin maqedonas apo shqiptare, duhet që të ulin dozat e nacionalitetit dhe të shpalosin, programe konkrete për mirëqenien e secilit qytetarë që jeton brenda territorit të RMV-së pa marrë parasysh përkatësinë etnike apo fetare, kjo vlen mbi të gjitha për zgjedhjet parlamentare që në fakt ishin të pandashme gjatë gjithë fushatës elektorale presidenciale.

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh etninë e tyre, më shumë se asnjëherë janë të bombarduar nga retorika boshe dhe folklorizëm politik. Asnjë premtim apo zotim i drejtpërdrejtë që ka në prioritet qytetarin, ndoshta edhe për shkak të funksioneve të kufizuara që ka institucioni i presidencës.

“Evropa është e vdekshme”, paralajmëron sërish Macron ndërsa bën thirrje për më shumë unitet e sovranitet të BE

Blloku 27-vendesh duhet të rimendojë urgjentisht modelet e tij të mbrojtjes dhe ekonomike për të mos mbetur prapa rivalëve të tij, tha udhëheqësi francez.

Modeli evropian rrezikohet të vritet nga rivaliteti SHBA-Kinë dhe dekada e ardhshme do të jetë vendimtare për mbijetesën e tij, paralajmëroi të enjten presidenti francez Emmanuel Macron, duke i bërë thirrje Bashkimit Evropian të bëhet gjithnjë e më i bashkuar dhe sovran.

Në një fjalim 108-minutësh të mbajtur në Sorbonë, ku shtatë vjet më parë lideri i sapozgjedhur atëherë mbajti fjalimin e parë mbi vizionin e tij për Evropën, Macron përsëriti shumë herë se “rregullat e lojës kanë ndryshuar” në disa fronte, përfshirë gjeopolitikën, ekonomia dhe tregtia dhe kultura.

“Ne duhet të jemi të qartë në lidhje me faktin se Europa jonë sot është e vdekshme. Ajo mund të vdesë. Mund të vdesë dhe kjo varet vetëm nga zgjedhjet tona, por ato zgjedhje duhet të bëhen tani,” u tha Macron të pranishmëve duke përfshirë anëtarë të qeverisë së tij dhe ambasadorë nga shtetet e tjera anëtare.

“Iku koha kur Evropa bleu energjinë dhe plehrat e saj nga Rusia, ia kaloi prodhimin Kinës dhe delegoi sigurinë



e saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës,” shtoi ai. Hapat pozitivë janë bërë gjatë viteve të fundit, vuri në dukje ai, por megjithatë paralajmëroi se “ne nuk jemi në shkallë”. Ndër shqetësimet kryesore të tij ishin lufta në Ukrainë dhe implikimi i saj për mbrojtjen dhe sigurinë evropiane, si dhe aftësinë e aktorëve industrialë dhe teknologjikë evropianë për të mbijetuar kundër asaj që ai e përshkroi si “mbi-subvencionim” i ekonomive të tyre nga SHBA-ja dhe Kina.

“Nuk duhet të harrojmë kurrë se ne (evropianët) nuk jemi si të tjerët”, tha Macron, duke përmendur lidhjen e evropianëve me lirinë, demokracinë, sun-

dimin e ligjit dhe barazinë. Por këto vlera janë gjithnjë e më shumë nën kërcënimin e dezinformimit dhe propagandës.

Ndër idetë e tij për të nxitur lidhjet brenda-evropiane ishin krijimi i diplomave evropiane (një propozim që Komisioni Evropian zbuloi së fundmi), dhe i aleancave të muzeve dhe bibliotekave evropiane, ndërsa ai mbrojti një “shumicë dixhitale” të vendosur në 15 për të mbrojtur të rinjtë nga kurthet e mundshme të jetës në internet. Ai mbështeti gjithashtu një forcimin e mekanizmit të sundimit të ligjit të bllokut që synon të sanksionojë shtetet anëtare që minojnë vlerat e BE.

Dear readers and followers of Argumentum.al

On the third anniversary of the founding of the online media Argumentum.al, now it comes in the version of a monthly magazine which you can browse online from April 2022.

This monthly publication offers a clear combination of news on Albania, the Western Balkans and the world, as well as opinions and analyses of events taking place during the month.

Thanking each of you for your attention and trust in our media, we promise that we will continue to publish objective analysis on key developments in the country, region, Europe and the world.

Argumentum.al strives to be an authoritative source of journalism with analyses and comments on international relations, world politics and a wide range of issues of global importance by publishing exclusive materials. This is done thanks to the contribution of some of the well-known names of Albanian politics and journalism and other local and foreign collaborators. At the same time, Argumentum.al is open for comments and opinions by its readers.

Read on domestic and international issues in the magazine Argumentum.al free of charge in Albanian and English!

“Argumentum”, an intellectual process...



Opposition Candidate Wins First Round of North Macedonia's Presidential Vote

In a resounding first-round victory, the opposition VMRO DPMNE-backed candidate, Gordana Siljanovska-Davkova, took 40.08 per cent of the vote in Wednesday's first round of presidential elections, far ahead of the incumbent, Stevo Pendarovski, endorsed by the ruling Social Democrats, who got 19.93 per cent.

The results came after more than 99 per cent of the votes were counted. Since no candidate won more than 50 per cent, the two frontrunners will compete in a run-off on May 8, which will take place in parallel with a higher-stakes general election.

The result was "inspiring", Siljanovska-Davkova said in a victory speech just before midnight. She thanked VMRO DPMNE voters for their support but also those who voted for other candidates, pledging that if elected she will respect and cooperate with all political forces in the country. "Everyone who truly wishes Macedonia well should come together, and we should not confine ourselves only to the frame of Macedonia, but should act regionally, to help each other and use all forms of cooperation," she said. In a late-night address, Pendarovski admitted that his result was "far from what was expected" but insisted that "from tomorrow, it's a new day and we are starting from zero".

Of the candidates attracting votes from the large ethnic Albanian community, Bujar Osmani, from



the junior ruling party, the Democratic Union for Integration, DUI, bested his opponent from the joint Albanian opposition VLEN bloc, Arben Taravari. Osmani won 13.36 per cent while Taravari won 9.21 per cent.

Osmani said this clearly reflected the will of the Albanian people. But the Albanian opposition bloc declined to congratulate him. One of the leaders of the VLEN alliance, Bilal Kasami, claimed the DUI achieved its result fraudulently. "The DUI bought votes from vulnerable voters who are in need of money," he said, without providing evidence.

Among the remaining three candidates, the mayor of Kumanovo and head of the recently-formed ZNAM party, Maksim Dimitrievski, had most reason to celebrate. He won 9.26 per cent of the vote, claiming fourth place overall.

Biljana Vankovska, candidate of the Levica (Left) party, won 4.55 per cent, while the mayor of Sko-

pje's Karposh municipality, Stevo Jakomovski, won just 0.9 per cent.

Out of 1,814,317 registered voters, 904,892 cast ballots, meaning that the turnout in the first round was 49.95 per cent.

The first round of presidential polls is expected to inform the outcome of the general elections, which will be held in two weeks' time. VMRO DPMNE is seeking to defeat the Social Democrats, who have been in power since mid-2017.

In a speech on Wednesday night, VMRO DPMNE leader Hristijan Mickoski called on all the country's other political forces and on undecided voters to unite behind him.

In a reference to the politically influential Albanian camp, Mickoski indicated that he favoured the VLEN opposition bloc, which he congratulated on its result, and called on it "not to let DUI get a good result" in the parliamentary polls in two weeks.

Paris, Prime Minister Rama is honored at the official ceremony held in the Court of Honor of “Les Invalides”



On the second day of his visit to France, Prime Minister Edi Rama, accompanied by his wife Linda Rama, was honored at the ceremony held in the Court of Honor of “Les Invalides”, in Paris, a well-known complex of museums and monuments, connected with the military history of France.

Prime Minister Rama and his wife were hosted at the entrance portico by the Minister for Europe Jean-Noël Barrot and by the Military Governor of Paris, Corporal General Christophe Abad.

Afterwards, the Prime Minister, accompanied by the Commander of the Republican Guard troop, crossed the Court of Honor, in the presence of three lined up platoons of the Guard.

The national anthems of Albania and France followed the protocol of the ceremony and then Prime Minister Rama, accompanied by the Troop Commander, paraded in front of the Guard platoons.

The Prime Minister, accompanied by the Commander of the Republican Guard troop, crossed the Court of Honor, in the presence of three lined up platoons of the Guard. The national anthems of Albania and France followed the protocol of the ceremony and then Prime Minister Rama, accompanied by the Troop Commander, paraded in front of the Guard platoons.



The military honors before Prime Minister Rama were presented by a detachment composed of the orchestra of the Republican Guard and three platoons of the infantry regiments of the Republican Guard.

Electoral elections as geopolitics: North Macedonia towards the West or Russia and Germany's reaction

Write: Dr. Gurakuç Kuçi
 Researcher at the Institute for
 Hybrid Warfare Studies OCTOPUS

Electoral elections are no longer simply a democratic enterprise organized to steer economic-social development, they now also have their geostrategic and geopolitical importance, becoming an important part of hybrid war strategies. After Montenegro, we are also seeing this in North Macedonia, where the German chancellor Olaf Scholz got involved, presenting a western attitude and not just his personal preference.

Electoral processes have begun to evolve from internal social-political and economic issues to a major force in the formation of politics and geopolitics.

The elections in the USA from 2016 until today, then in Germany, Italy and other European countries show that the ideological changes of the parties are not only appearing as internal changes in economic and social development but also external geopolitical. But these changes are hitting the most third countries. Autocratic regimes such as Russia and Serbia have recognized the potential of electoral processes through hybrid warfare as a weapon to exert influence on fragile democracies, including North Macedonia and Montenegro. This manipulation of democratic processes is a manifestation of hybrid warfare, where political, economic and informational strategies are used to achieve strategic objectives.

Recently, we are witnesses for the statement of German Chancellor Olaf Scholz on the elections in North Macedonia, clearly demanding to vote for SDSM. This statement of Mr. Scholz is not just a personal preference of his, but a calculated move within a comprehensive strategy to protect the



main interests of NATO and the EU in the strategic region of the Western Balkans.

Any change in North Macedonia's political landscape that does not align with Western interests could potentially create a dangerous anti-Western and quasi-Western axis, including Serbia, Republika Srpska, Montenegro and North Macedonia. This development could have far-reaching implications for the stability and security of the entire region, and thus, for the interests of the West. In this context, electoral processes have become a critical component of geopolitical influence, forming alliances and influencing international relations. As such, understanding the dynamics of electoral politics in third countries is essential to research into the complexities of the contemporary global order. So we are to the

“electoral elections as geopolitics” trend.

For example, in the USA the electoral challenge between the candidates Joe Biden and Donald Trump is not just a political duel within their borders, but it is also a spectacle that can deeply affect the global geopolitical structures. In this context, it is carefully observed how the change of government in the USA could potentially affect its geopolitical orientation and relations with international actors.

During this election period, it is hard not to notice the influence of outside interests on the campaign and the election results of the USA. In a changed and important geopolitical environment, international actors use their diplomatic, economic and propaganda tools to influence the course of events in the most

powerful country in the world. In the context of the geopolitical challenges of the Western Balkans, the actions of Russia and Serbia through the use of hybrid warfare strategies in North Macedonia represent a clear attempt to influence the outcome of the elections and to manipulate the political structures in favor of their interests. In this scenario, the goal is to create an unstable political situation, which will result in an uncertain government, and will keep North Macedonia in a similar state as that of Montenegro.

In detail, this strategy intend to ensure a victory for right-wing nationalist parties such as VMRO-DPMNE, linking them with a left-wing movement such as Levica, to create a governing coalition that includes some Albanian coalition in the name of multi-ethnicity and pro-Western guarantee, however, under the conditions of such a government, state and institutional stability cannot be guaranteed.

In this situation, the Western powers will be forced to accept such a governance structure in the name of stability, as they did before in the case of Montenegro. Stability can be restored in a challenge but not from the Albanian factor as it is important to determine that the risk of worsening ethnic tensions in North Macedonia has no source in the Albanian factor. Instead, ethnic tensions mainly stem from internal Macedonian factors.

Albanians, whether politically or ethnically, have demonstrated a stable state consciousness towards North Macedonia, maintaining a

pro-Western orientation and expressing their will to be part of the country's state and political structures. This permanent position of theirs has constituted a stabilizing element in the political landscape of North Macedonia, regardless of the changes in the ideological and strategic characters of the political parties from the Macedonian side.

Therefore, in order to understand and address the ethnic tensions in North Macedonia, we must return to the challenges and dynamics within the Macedonian community, examining them in the context of the country's history and domestic politics, and identifying their main sources to find sustainable and long-term solutions for the stability and continued development of North Macedonia.

In order to maintain the integrity of North Macedonia and to avoid widespread Russian-Serbian influence, one of the main challenges it must take seriously is economic and social development. In order to achieve this objective, it is important that the political, intellectual and civic classes of North Macedonia play the role of true patriots, trying to protect its independence and advancing on the path of sustainable development.

This process requires the political and social actors of the country to work in harmony to avoid the involvement of foreign policies that could lead to state capture, thus creating a favorable climate for sustainable development and for the progress of the country. On the contrary, political disputes and tensions can cause social re-

volt and destabilization, endangering the existence of North Macedonia as a state entity in the current political structure.

In this context, it is important that North Macedonia seriously estimate the internal and external challenges, taking as an example how they are faced and handled by Montenegro. The strong connection with NATO and the integration efforts in the European Union are also essential to guarantee the security and development of the country in a changed geopolitical context. Therefore, it is important that North Macedonia continues to understand and take appropriate steps to maintain its integrity and fulfill its strategic objectives on the international stage.

These conclusions become evident from the paper with the title: "Hybrid Warfare and the Importance of Elections in Geopolitics: North Macedonia as a part of the West or Returning to the Sphere of Russia and Serbia" published by OCTOPUS Institute. This paper examines the issue of how North Macedonia at its government, had a political subject with strong pro-Russian and pro-Serbian segments, to then change to another pro-Western subject after many challenges and which is now in danger of backsliding again like before 2016 or worse.

During the paper, we examined the threats of serbization in North Macedonia, Russian influence and commitments to change the approach towards the West and the hybrid war which, in addition to damaging North Macedonia, was strong enough to be involved in the USA elections.

Zelenski in Tirana! Summit for the sake of summit! Not like Nastradin's music! If you want peace, prepare for war! EBRD and Basso strips off our veil”!

REALPOLITIK FLASH NO. 68

| 1 – 30 APRIL 2024

| EXCLUSIVELY FOR ARGUMENTUM

By DR. JORGJI KOTE


GRAND MASTER IN DIPLOMACY

Oxygene for the German economy! This was also confirmed during the visit by the German Chancellor Olaf Scholz in China (14 – 16 Prill).

In his meeting with President Xi, the latter renewed the message of the EU – China Summit last December in Peking that “de-coupling and de-risking with China are not realistic and productive options and that relations with China are not a risk but an opportunity for development”.

Last year official Berlin endorsed the new strategy on China, which emphasizes that foreign policy would rely on values and principles”. Although this sounds beautiful music, its implementation in the vital economic area is almost impossible.

Perhaps this is why Chancellor Scholz started his three – day visit in China in commercial Schongqing tregtar, among the largest world cities with 32 million inhabitants, with 84 German companies active there, continued to economic Shangaj and ended it in political Peking. In his second visit within two years



there, while his predecessor, Chancellor Merkel visited Peking 14 times in 16 years in power!

Now, as for the large German economic dependency from China, no one is to blame, even less China; besides the abundant German benefits. Thus, in 2019, the German sales to China represented 48,5 per cent of European exports; economy has become a decisive factor for the German government survival and electoral success. During 2023, the German economic growth was 0,1 from 1, 3 per

projected, whereas the Chinese economy grew 5,3 from projected 4,5 per cent. For the eighth consecutive year, China is the largest commercial partner for Germany. Accordingly, without exports and investments in China, the German economy has little chances of survival.

Actually, the “ ugly truth ” is that most recently, despite debates on the future economic cooperation with China, in general the German might is closely connected with the economy and trade relations with China.

Iran attacks Israel with over 300 drones, missiles



Iran launched a large aerial attack on Israel and the territory it controls starting late on Saturday, firing at least 300 drones and missiles. It is the first such direct attack launched from Iranian territory after decades of shadow warfare between the two countries. The assault was in response to a recent strike on a building in the Iranian Embassy complex in Syria that killed several of Iran's top commanders.

Air raid sirens sounded in Israel and the West Bank overnight, signaling the start of an attack that had been anticipated for days. In the event, almost all of the missiles and drones were intercepted, the Israeli military said on Sunday.

Israel had used two primary defensive weapons systems, the Iron Dome and the Arrow 3, to thwart the attack. The United States participated in the defensive actions, and Defense Secretary Lloyd J. Austin III said that U.S. forces

had intercepted missiles and attack drones launched from Iran, Iraq, Syria and Yemen.

Britain also said its planes had shot down drones. In addition, Jordan, which neighbors Israel, said that its military shot down aircraft and missiles that entered its airspace.

The attack caused no deaths, but 12 people were brought in to the Soroka Medical Center in southern Israel overnight. Rear Adm. Daniel Hagari, the chief spokesman for Israel's military, said the Nevatim air force base in the Negev desert in southern Israel suffered light damage from the attack and was functioning.

What was the immediate cause of the attack?

Iran and Israel have for decades engaged in clandestine warfare, in which they have attacked each other's interests on land, sea, air and in cyberspace. Iran provides support for proxy forces including

Hezbollah in Lebanon, Hamas in the West Bank and Gaza and the Houthis in Yemen. Israel has launched a series of attacks including killing Iran's top nuclear scientist, Mohsen Fakhrizadeh, in 2021, and assassinating a Revolutionary Guards commander, Col. Sayad Khodayee, in 2022.

The undeclared conflict escalated on April 1, when Israeli warplanes struck the building in Damascus that is part of the Iranian Embassy complex, according to Iranian and Syrian officials. At least three senior commanders and four officers overseeing Iran's covert operations in the Middle East were killed. Iran vowed to retaliate.

Iran's attack comes more than six months after a deadly incursion led by Hamas on Israel, which sparked the war in Gaza. In the immediate term, the attack could distract attention from that conflict, but it also shows the region's wider volatility.



Adresa: Njësia bashkiake nr. 5, Rruga "Abdyl Frasheri", Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 68 82 01 720

**Email: redaksia.argumentum@gmail.com,
info@argumentum.al**

NUIS/NIPT: L91415033Q

Twiter : [Argumentum_al](#)

Facebook: [argumentum.al](#)

Instagram: [argumentumnews](#)

© Argumentum. All rights reserved